

NDIKIMI I GLOBALIZIMIT KULTUROR NË NDRYSHIMET KULTURORE DHE RRJETET SOCIALE NË TURIZËM RAST STUDIMI: SARANDA SHQIPËRI

Fisnike PLLANA¹

Abstract

The term "globalization" was coined by the Americans. The French have preferred the term "globalization". Globalization can be understood, more easily, through the transformation of local processes and regional phenomena, as a whole. Globalization represents the combination of economic, technical-technological, sociocultural and global political forces. What characterizes it is the union of people, which functions as a single society. Globalization represents a combination of economic, technological, sociocultural and political forces. Based on the definition of Prof. Palmer (CATO Institute), regarding globalization: "globalization represents the reduction or elimination of social restrictions, which is a special phenomenon, but it aims to exchange goods and increases the complex global system of production and exchange of goods", thus the effects of globalization are multiple, but mainly reflected through industrial, financial and economic effects.

There is a doubt that globalization does not possess the treatment of a particular phenomenon, but it represents another expression; for modern imperialism and the strengthening of the dominance of developed countries over undeveloped ones. The process of globalization, through the opening of state borders for world business and through the formation of uniform rules at the world level, the whole world, the economies of states tend to take advantage of their comparative advantages, transforming them into competitive advantages, in order to long-term increases in the living standards of the population are ensured.

Përmbledhje

Termi "globalizim" është vënë në qarkullim nga amerikanët. Francezët kanë parapëlqyer termin "mondializim". Globalizimi mund të kuptohet, më lehtë, përmes transformimit të proceseve lokale dhe fenomeneve regjionale, në tërësi. Globalizimi paraqet kombinimin ekonomik, tekniko-teknologjik, sociokulturor dhe forcave politike globale. Ajo që e karakterizon është bashkimi i njerëzve, i cili funksionon si një shoqëri e vetme. Globalizimi përfaqëson një kombinim të ekonomik, teknologjik, sociokulturor dhe politik forcë. Në bazë të definicionit të Prof. Palmer (Instituti CATO), lidhur me globalizimin: "*globalizimi paraqet zvogëlimin ose eliminimin e kufizimeve shoqërore, që është një fenomen i veçantë, por ka qëllim ndërrimin e mallit dhe rritet sistemi global kompleks i prodhimit dhe ndërrimit të mallërave*", kështu efektet e globalizimit janë të shumfishta, por kryesisht reflektohen përmes efekteve industriale, financiare dhe ekonomike.

Ekziston dyshimi se globalizimi nuk posedon trajtimin e një fenomeni të veçantë, por ai përfaqëson një shprehje tjetër; për imperializmin modern dhe forcimin e dominimit të vendeve të zhvilluara ndaj atyre të pazhvilluara. Procesi i globalizimit, përmes hapjes së kufijve shtetërorë për biznesin botëror dhe përmes formimit të rregullave uniforme në nivel botëror, e gjithë bota, ekonomitë e shteteve priren të përfitojnë nga përparësitë e tyre krahasuese, duke i shndërruar ato në përparësi konkurruese, në mënyrë që të sigurohen rritje afatgjate të standardeve të jetesës së popullsisë.

Roli i globalizimit në Sarandë: Shqipëri

Saranda është një qytet me më shumë se 2000 vjet, i ngritur në zonën e bregdetit jugor të Shqipërisë, i pasur në vlera të rralla të trashëgimisë kulturore dhe arkeologjike shqiptare, por edhe evropiane. Në fillimet e tij, qyteti ka shërbyer si një portë për qytetin antik të Finiqit dhe si rrjedhojë edhe si portë hyrjeje për në rajon. Kjo trashëgimi e pasur arkeologjike e gërshetuar me bukuritë e natyrës, si dhe portin e saj natyral, përbën bazën më të rëndësishme për të promovuar zhvillimin e imazhit aktual të Sarandës, si një destinacion *i turizmit klasik botëror*, si dhe për të tërhequr tregun e turizmit të veçantë.

Rrënojat antike të Sarandës

Teatri i shekullit të IV para Krishtit, skena e tij, statujat dhe objektet e zbuluara ndër vite, për të gjithë të interesuarit, janë shumë mbresëlënëse për studiues dhe vizitorë. Një prej monumenteve më të rëndësishme të Sarandës, paraqet objekti i kultit, *nga shekulli XV* por është prekur me kalimin e kohës si rezultat i jetesës njerëzore.



Manastiri i 40 Shenjtorëve, foto nga IntoAlbania.



Shkallët e Sarandës **Burimi:** Piotrus

Disa pamje të qytetit të Sarandës, nga viti 1945-1970 (pa vizitorë të huaj, vetëm me një numër shumë të vogël të pushuesve vendor):



Klima tipike mesdhetare e Sarandës

Saranda ka një **klime tipike mesdhetare**. Saranda ka numrin më të lartë të ditëve me diell edhe në Evropë, mbi 270 ditë.

Pasuritë natyrore

Zona e Sarandës karakterizohet nga një numër i madh habitatesh natyrore, gjysmënatyrore dhe artificiale. Ka një bimësi të larmishme tipike mesdhetare. Zona njihet për prodhimin e agrumeve dhe ullirit, ndërkohë që pemët frutore zënë rreth 30 për qind të sipërfaqes.

Banorët e Sarandës-demografia

Nën juridiksionin e bashkisë janë pesë lagje dhe tri fshatra: Gjashta, Metoqi dhe Shelegari. Në janar *të vitit 2007, qyteti numëronte mbi 35.000 banorë* dhe njihet si një zonë me emigracion të madh. Jeta mesatare i kalon të 72 vjetët. Qyteti bregdetar ka një përbërje të larmishme etnike dhe krahinore. Pas Luftës së Dytë Botërore, popullsia e qytetit të Sarandës u rrit në mënyrë të qëndrueshme deri në rënien e komunizmit në vitin 1992. Pas kësaj date, qyteti i Sarandës kishte *rritje të shpejtë së popullsisë kur shumë shqiptarë nga rajone të tjera u vendosën atje*.

Në vitet 1960-1980, Saranda promovohet si "**ofertë turistike e Shqipërisë**" jo vetëm për vizitorët shqiptarë, por edhe për **ata pak vizitorë të huaj që gati numëroreshin me gishta** në shtetin e rrethuar me tela në mes të Evropës. Por gjatë kësaj periudhe u kryen edhe investimet e para, veçanërisht në kurorën e gjelbër të Rivierës. Mijëra të rinj punuan në aksione për t'i kthyer kodrat përreth në brezare ullinjsh, portokajsh dhe limonësh.

Nga viti 1960 deri në vitin 1982, popullsia e Sarandës u rrit me një ritëm mesatar vjetor prej 2,7 për qind. Në atë periudhë qyteti i Sarandës numëronte rreth 15 mijë banorë dhe zhvillimi ishte mjaft i kufizuar. Në vitet 1990-2004 qyteti njeh një ritëm zhvillimi dhe një rritje të popullsisë, kryesisht prej ardhjes së mjaft familjeve nga zona të ndryshme të Shqipërisë. **Në vitin 1999 popullsia ishte 26.512 banorë.**

Zhvillimi i qytetit të Sarandës pas vitit 2000

Qyteti i Sarandës njohu një zhvillim të vullshëm të sektorit bankar, pas vitit 2000. Bankat kryesore në Shqipëri kanë hapur në këtë qytet filialet e tyre, duke i kushtuar veçanërisht rëndësi **shërbimit bankar gjatë sezonit veror**. Deri tani ushtrojnë aktivitetin e tyre bankar mbi 12 operatorë dhe shumë shpejt pritet të hapen edhe 2 të tjera, ç'farë bën të mundur akomodimin e turistëve dhe **kryerjen e shërbimeve bankare, këmbimin e valutave të ndryshme evropiane e botërore**.

Në amfiteatrin e qytetit antik të Butrintit mbahet për çdo vit Festivali Ndërkombëtar i Teatrit "Butrint 2000", me pjesëmarrjen e mjaft trupave teatrore evropiane. Në kinoteatrin e Sarandës vihen në skenë shfaqje të shumta. Gjatë muajve të verës jo vetëm trupa e estradës së Sarandës, por edhe trupa të tjera brenda dhe jashtë vendit, japin shfaqje të ndryshme në qytetin që "përmbytet" nga vizitorët. Në qytetin e Sarandës ndiqen tre kanale televizive lokale, si dhe të gjitha kanalet kombëtare, duke mos përjashtuar edhe disa kanale televizive greke dhe disa kanale italiane. Gazetat kombëtare mbërrijnë në qytet nga Tirana afër mesditës, ndërsa gjatë sezonit del në Sarandë gazeta "Saranda", e cila ka një pjesë të faqeve dhe në gjuhën angleze.

Tregu i frutave dhe i perimeve, ku gjenden ushqime organike të fermerëve të zonës, është në qendër të qytetit. Saranda ka traditë në prodhimet bujqësore dhe gjatë verës tregu njeh çmime mjaft të favorshme. Por funksionojnë më së miri edhe marketet e vogla dhe të mesme, të cilat janë të shumëllojshme me artikujt e përdorimit të gjerë. Pothuajse gjatë gjithë ditës dyqanet ushqimore janë të hapura. Ndërsa njësitë që shesin suvenire janë në qendër të qytetit, fare pranë kinoteatrit.

Në Sarandë prodhimet e detit gatohen kryesisht të zgarë. Në përgjithësi, ushqimet janë të pjekura mirë, përdoret edhe gatimi me avull. Pjatat e dyta të mishit janë me bazë qengji, gici dhe viçi. Si pije gjatë ngrënies përdoret shpesh rakia dhe vera.

Saranda në vitin 2019

Duke u nisur nga hapja e Shqipërisë ndaj botës, filloi në vitin 1990, Saranda ka përfituar gjatë viteve të fundit prej tërheqjes së pushuesve **vendas** dhe **të huaj**. Vitet e fundit vihet re një shpërthim i industrisë së ndërtimit, i cili ka ndryshuar pamjen e qytetit nga një vend i qetë bregdetar pushimesh në një zonë masive ndërtimesh. Parku Kombëtar Arkeologjik i Butrintit është gjeneruesi parësor i turistëve ndërkombëtarë, të cilët vijnë kryesisht si vizitorë ditorë nga ishulli i Korfuzit në Greqi, pas një udhëtimi të këndshëm rreth një orë me anije.

Nga një port i vogël ku ankorohen edhe kryqëzorë, mijëra sy kureshtarë derdhin veshtrimet mbi kodrat e qytetit të Sarandës. Aty kacavirren shtëpitë, hotelet, bimësia e egër dhe shumëgjyrëshe, rrugët gjysëm urbane dhe lokalet e rregulluara vetëm për turizëm. Saranda është qyteti ku mbaron Riviera shqiptare, aty ndahet kufiri ujor me Greqinë, me një popullsi **prej 38 mijë banorësh që trefishohet gjatë muajve të ngrohtë të vitit.**

Pasurisë bimore të Sarandës i shtohet edhe bimësia ujore e detit Jon. Në thellësitë e Jonit nuk mungojnë edhe koralet. Zona u afron vizitorëve vendas dhe të huaj pamje spektakolare të ujërave blu. Zona e Sarandës ka një botë shtazore të pasur, si derri i egër, lepuri, çakalli, dhelpra, ujku, sorkadhja, thëllëza, rosa etj. Disa rezervate, si ai i pyllit të Butrintit, Stillos, Corrajt, Muzinës, janë një vend gjuetie mjaft i përshtatshëm për amatorët e këtij sporti. Edhe pasuria ujore dhe shtazore e detit Jon është e shumëllojshme. Delfinët janë miq të qytetit, duke u afruar brigjeve të Sarandës.

A ndryshon natyra e një kombi dhe identiteti i tij nën ndikimin e globalizimit?

Sigurisht, kjo ndodh. Derisa kuzhinat kombëtare integrojnë produktet dhe recetat e kuzhinave të tjera që kanë kaluar testet e kohës, kështu që edhe kulturat ndryshojnë. Por, kjo nuk do të thotë se, nën ndikime të jashtme humbet identiteti. Kulturat ndryshojnë me kalimin e kohës edhe pa ndikime të jashtme, nga vetvetja me rrjedhën e kohës.

Në vazhdim, disa pamje të qytetit të Sarandës, gjatë vitit 2019:





Përfundim

Ndër disa propozime pak a shumë të besueshme në lidhje me marrëdhëniet midis kulturës dhe globalizimit sigurisht që bëhet fjalë për ndërveprimet e tyre të shumta dhe domethënëse me njëri-tjetrin. Kultura është një pjesë e rëndësishme e mjedisit brënda të cilit realizohet globalizimi. Gjithashtu, globalizimi ndryshon shumë rrethanat kulturore, duke hequr pengesat e duhura, e njëherit përgatit terrenin për valë të reja të globalizimit, gjithnjë disi të modifikuara. Falë kulturës, por shumë më shpesh, përkundër saj, globalizimi krijon kushte për fillimin dhe *përshpejtimin e rritjes ekonomike*, dhe në shumë raste, për atë, në thelb qëndrueshmëri të rëndësishme.

Ritmi i rritjes, i cili është një përbërës i pandashëm dhe në të njëjtën kohë një përbërës i rëndësishëm i globalizimit të kulturave, ka një efekt stimulues ose kufizues në dy mënyra:

- Së pari, ndikon përmes mekanizmave të shumtë sjellja e individëve në sferën ekonomike të aktivitetit shoqëror, kështu që ekipi është padyshim një nga përcaktuesit e masës në të cilën një shoqëri e caktuar arrin të përdorë potencialin e saj njerëzor,
- E dyta dhe po aq e rëndësishme është edhe ndikimi i kulturës në rritjen ekonomike, dhe kështu në globalizim, në fakt kultura ndikon ndjeshëm në mundësinë e zbatimit të reformave gjithmonë të nevojshme. Shumë reforma mungojnë për shkak të barrierave kulturore.

Megjithëse nuk mund të flitet fjalë për fjalë për reformën kulturore, aq më pak për revolucionet kulturore të qëndrueshme, reformat mund të lëvizin një numër kufizimesh në rrugën e modernizimit të shoqërisë. Duke u nisur nga fakti se Shqipëria ishte e mbyllur nga viti 1945-1990, me një kulturë vetanake, pa informacione të bollshme për fqinjët dhe ndryshime të kulturave dhe ekonomive në shumë vende të botës. Kjo mbyllje, ka lënë vragë në memoriet e sarandiotëve dhe shqipëtarëve në tërësi, ca “të mira” e shumë për të dëshiruar.. Me hapje, ndaj vendeve fqinje, Europë dhe pothuaj në të gjitha kontinentet, me një shpejtësi të paimagjueshme shpërthyen shpërnguljet, nga dëshira për të arrijtur ato gjëra të mira apo të padobishme, bënë që të bëhet një përzierje e madhe, në emër të globalizimit!

Pas vitit 2000, kur pothuaj u krijuan kushte relativisht të favorshme për vizitorë të huaj në brigjet perla të Sarandës dhe tërë bregdetit shqiptar (më shumë se 475 km), u bë një përzierje e shumë kulturave, duke lëshuar e dëgjuar lloj-lloj muzike, përdorim i shumë fjalëve të gjuhëve të huaja, bastardimi i gjuhës shqipe, si dhe me një meny të larmishme të ushqimeve, varërisht nga dëshirat e vizitorëve.

Gjatë periudhës 1990-2019, u bë shkatërrimi i shumë muzeve, jo vetëm në Sarandë, por edhe në shumë qytete të Shqipërisë, u shitën dhe u shkatërruan shumë artefakte me vlera të paimagjueshme, çfarë paraqet një humbje të madhe për popullin shqiptar.

Përfundimisht, duhet të kemi kujdes për shëndetin e popullit tonë, në të gjitha Trojet Etnike, ruajtjen dhe kultivimin e gjuhës amtare, si, edhe pasuritë e dhuruara nga Zoti, varësisht globalizimit dhe kulturave të ndryshme të vizitorëve të huaj.

Referencat

- [1]. A.G. Hopkins (ed.): Globalization in World History. London: Pimlico, 2002.
- [2]. Held, David, et al. Global Transformations: Politics, Economics and Culture. Stanford: Stanford UP, 1999.
- [3]. Holton, R.J. : Making Globalization. Basingstoke: Palgrave Macmillan, 2005.
- [4]. Kopi Kçyçku: Globalizimi dhe identiteti ynë kombëtar. Shoqëria Kulturore Shqiptare Haemus, Prill 23 2019.